



# **Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri**

**Raporti i Universitetit “Aldent”**  
Korrik 2017

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1 Znj. Penny Renwick Kryetare

2 Prof. Jeremy Bradshaw Anëtar

3 Prof. Anila Hoda Anëtare

Datë:3-4 korrik 2017

PA Renwick

Jeremy Bradshaw

Anila Hoda

## **Përmbajtja**

Rreth këtij vlerësimi.....	1
Konteksti i këtij vlerësimi .....	2
Raport i përmbledhur .....	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	8
Raporti i detajuar.....	9
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij .....	9
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet .....	14
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula .....	19
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	24
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre .....	29
Lista e dokumenteve .....	33

## Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i vlerësimit institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle institucionet e arsimit të lartë (IAL-të) përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar, të caktuar nga QAA-ja dhe të ekspertëve shqiptarë, të caktuar nga APAAL-i. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që mbështetet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'iu ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxënit të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm iu referua Manualit të APAAL-it për vitin 2016-2017, Raportit të Vetëvlerësimit të Universitetit (RVV), një sërë dokumentesh që shërbenin si bazë faktesh, fakteve të kërkuara shtesë dhe mbledhjeve të organizuara me punonjës të niveleve të ndryshme, studentë dhe palë interes.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja ka ofruar ekspertë mbështetës për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, duke siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe për korrektimin dhe përmbledhjen e raportit të plotë për përmbledhjen që vijon.

## Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti "Aldent" u licensua në vitin 2003 si shkollë profesionale, që ofronte programe dyvjeçare për laborantë dentarë. Përpara se të merrte statusin e universitetit në vitin 2013, "Aldenti" pësoi një sërë zhvillimesh. Ai ofron programe studimi në të tre ciklet, në përputhje me strategjinë dhe misionin e tij. Aktualisht, universiteti ka 1,250 studentë, të cilët ndjekin programet Bachelor për laborant dentar, fizioterapi, infermieri të përgjithshme dhe teknikë laborator mjekësore; programet e Masterit të Shkencave në fizioterapi, stomatologji dhe farmaci; si dhe programet e specializimit afatgjatë në stomatologji, që përqendrohen në ortodonci dhe kirurgji orale. Të gjitha programet janë me kohë të plotë dhe ofrohen në gjuhën shqipe. Me përjashtim të programeve të sapohapura në Masterin e Shkencave në Fizioterapi dhe programit Bachelor për Teknikë Laboratori Mjekësore, programet e tjera janë të akredituara nga APAAL-i.

Gjatë kohës së kryerjes së vlerësimit të jashtëm, universiteti përbëhej nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore, që ndahej në departamentin e Farmacisë dhe në departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë; si dhe Fakulteti i Shkencave Dentare, që ndahej në departamentet e Stomatologjisë dhe të Laborantëve Dentarë. Krahas këtyre, universiteti ka edhe dy njësi kërkimore: Qendrën e Shërbimit dhe Formimit Klinik dhe Qendrën Kërkimore Farmakoterapeutike. Universiteti ka 51 anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë dhe 73 anëtarë të me kohë të pjesshme. Ai ka edhe 28 laboratorë dhe dy biblioteka.

## Raport i përmbledhur

Universiteti "Aldent" (universiteti), i cili nisi ushtrimin e veprimtarisë së tij në vitin 2003 duke ofruar fillimisht programin dyvjeçar për laborant dentar, është një institucion jopublik profesional, që ndodhet në qendër të qytetit të Tiranës. Përpara se të merrte statusin e universitetit në vitin 2003, universiteti pësoi një sërë zhvillimesh.

Aktualisht, ai ofron programe studimi në të tre ciklet, në përputhje me strategjinë dhe misionin e tij. Aktualisht, universiteti ka 1,250 studentë, të cilët ndjekin programet Bachelor për laborant dentar, fizioterapi, infermieri të përgjithshme dhe teknikë laborator mjekësore; programet e Masterit të Shkencave në fizioterapi, stomatologji dhe farmaci; si dhe programet e specializimit afatgjatë në stomatologji, që përqendrohen në ortodonci dhe kirurgji orale. Të gjitha programet janë me kohë të plotë dhe jepen në gjuhën shqipe. Gjatë kohës së kryerjes së vlerësimit të jashtëm, universiteti përbëhej nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore, që ndahej në Departamentin e Farmacisë dhe Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë; si dhe Fakulteti i Shkencave Dentare, që ndahej në Departamentin e Stomatologjisë dhe Departamentin e Laborantëve Dentarë. Krahas këtyre, universiteti ka edhe dy njësi kërkimore, Qendrën e Shërbimit dhe Formimit Klinik dhe Qendrën Kërkimore Farmakoterapeutike. Universiteti ka 51 anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë dhe 73 anëtarë të me kohë të pjesshme. Ai ka edhe 28 laboratorë dhe dy biblioteka.

Raporti i Vetëvlerësimit u përgatit nga ekipi i ngritur nga universiteti, që përbëhej nga disa anëtarë personeli dhe një përfaqësues i studentëve. Projektraportet iu shpërndanë një audience më të gjerë në universitet, përpara përfundimit dhe miratimit nga Rektori.

Vizita u krye përgjatë dy ditëve, në datat 3 dhe 4 Korrik të vitit 2017. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë të nivelit të lartë për arsimin e lartë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe nga një anëtar me përvojë në arsimin e lartë, pjesë e personelit të institucionit shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mbështetej nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një mbajtës shënimesh, të caktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri (APAAL). Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe një dosje me dokumente mbështetëse, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuar më pas nga dokumentet e kërkuara shtesë. Larmia e informacionit mbështetës të siguruar nga universiteti, mundësoi njohjen e grupit me strukturën, politikën dhe procedurat e drejtimit, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë së ndërmarrë profesionale. Dokumentet përfshinin Statutin e Universitetit, rregulloret akademike, raportet vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, listën e marrëveshjeve të jashtme, shembujt e informimit rreth programit dhe dokumentet e mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë vizitës së vlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me drejtuesit e nivelit të lartë, studentët, pedagogët, personelin mbështetës dhe administrativ, si dhe me partnerët, alumnit dhe punëdhënësit. Diskutimi shërbeu për qartësimin e procedurave, përgjegjësi dhe pikëpamjeve. Gjatë të gjitha takimeve u mbajtën shënime. Si pjesë e turit të burimeve të mësimdhënies, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi dy vendndodhje të kampusit, si dhe bibliotekën, ambientet e mësimdhënies, zyrat dhe larminë e laboratorëve dhe workshop-eve.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë dhe nuk identifikoi asnjë dobësi ose veprim tashmë të ndërmarrë. Struktura drejtuese e universitetit është e përshtatshme dhe efikase, duke mundësuar arritjen e misionit, vizionit dhe objektivave institucionale. Senati Akademik përcakton strategjinë dhe politikën e universitetit, koordinon veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimore, si dhe vlerëson efikasitetin e tyre, ndërsa Këshilli Studentor bashkëpunon me universitetin për sigurimin e përfaqësimit të studentëve në komisione, interesat e të cilëve mbështeten nga njëri prej

anëtarëve të komisionit përkatës. Në Planin Strategjik të Universitetit, përcaktohen qëllimet e tij, të cilat janë: rritja e cilësisë së mësimdhënies, rritja e kapaciteteve akademike, përmirësimi i infrastrukturës, nxitja e ndërmarrjes së kërkimeve shkencore nga ana e personelit dhe studentëve, si dhe diversifikimi i burimeve financiare.

Ecuria e universitetit lidhur me objektivat strategjike monitorohet nga Rektorati dhe Senati, të cilët hartojnë planet e veprimit, duke përfshirë afatet dhe treguesit kyç të performancës për çdo pjesë të planit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi qasjen sistematike të universitetit për ndjekjen e përfundimeve të Raportit të Vlerësimit të Jashtëm dhe të ecurisë lidhur me objektivat strategjike, si karakteristikë të praktikës së mirë. Megjithatë programet e studimit lidhen me profesionet e rregulluara, universiteti merr informacione edhe nga organizatat profesionale. Gjatë përgatitjes së programeve të reja të studimit, universiteti merr parasysh tregun e punës në sektorin e mjekësisë. Për shembull, rezultatet e studimeve të tregut treguan se ka mungesë të specialistëve të fushës së kirurgjisë orale dhe ortodontisë në rang kombëtar, gjë që solli krijimin e një programi afatgjatë në këto fusha specializimi dentare. Strategjia e universitetit përcakton përparësitë për bashkëpunim dhe bashkëveprim. Universiteti ka lidhur marrëveshje me qendra spitalore universitare, spitale private dhe institucione jashtë lëmit akademik për t'i ofruar studentëve stazhe. Strategjia e Universitetit përfshin edhe thithjen e fondeve nga programet evropiane. Aktualisht, universiteti ka aplikuar në disa projekte ndërkombëtare. Universiteti ofron mobilitet ndërkombëtar për stafin akademik dhe studentët. Ai organizon konferenca ndërkombëtare dhe ofron mbështetje financiare për ata anëtarë të stafit akademik dhe studentë, që dëshirojnë të marrin pjesë në veprimtari ndërkombëtare. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi vështirësi të qenësishme në mobilitetin e studentëve për programet klinike, për shkak të kërkesës për kurrikula plotësuese, dhe vlerëson punën e pareshtur të universitetit në përafrimin e kurrikulës së tij me standardet evropiane.

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi apo nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë. Universiteti ndjek një politikë të hapur për rekrutimin dhe punësimin e stafit. Gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të stafit akademik, i jepet përparësi përvojës profesionale, e ndjekur nga reputacioni, përvoja dhe aftësitë pedagogjike, kualifikimet akademike dhe dosja e punimeve shkencore. Universiteti synon veçanërisht rekrutimin e punonjësve akademikë tejet të kualifikuar, të cilët janë diplomuar dhe kualifikuar në universitete ndërkombëtare. Universiteti e ndihmon dhe e nxit stafin akademik në kualifikime profesionale, botime dhe kërkim shkencor, përmes ofrimit të informacioneve, infrastrukturës, logjistikës dhe kontakteve përkatëse. Ai nxit politikën e vlerësimit të aftësive dhe shprehive të personelit të tij, bazuar në përshkrimet e çdo pozicioni pune, të miratuara nga Senati Akademik. Kriteret e vlerësimit përfshijnë mësimdhënien, administrimin dhe kërkimin. Buxheti vjetor hartohet në përputhje me përparësitë e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit. Departamentet mund të kërkojnë financim shtesë për mbështetjen e mjeteve dhe materialeve mjekësore, projekteve kërkimore, konferencave shkencore, botimeve apo aktiviteteve formuese. Për mundësimin e shkëmbimit të informacionit dhe analizimit të të dhënave, që shërbejnë si bazë për vendimmarrjen dhe përgatitjen e Strategjisë së Zhvillimit, universiteti koordinon sistemet e tij të informacionit.

Ai ka edhe një platformë online për drejtimin institucional, ndërsa sistemi mund të përdoret edhe për ofrimin e raporteve të ndryshme, si p.sh përmbledhjen e performancës, frekuentimin dhe ecurinë e studentëve. Gjithashtu, ekziston portali i studentëve dhe sistemi i menaxhimit të mësimdhënies, që së bashku, i ofrojnë personelit dhe studentëve akses në larinë e informacioneve lidhur me programet e tyre të studimit. Infrastruktura e universitetit është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për qëllimet arsimore dhe kërkimore, si dhe veprimtari të administrative dhe sociale. Megjithatë, në Planin Strategjik 2016-2020, ndërtimi i një kampusi universitar modern, i cili do të ofrojë ambiente sportive që aktualisht mungojnë, identifikohet si një prej qëllimeve të universitetit. "Aldenti"

ofron një sërë shërbimesh në përputhje me nevojat e komunitetit vendas, ku përfshihet ofrimi i shërbimeve stomatologjike falas për grupet e cenueshme, kërkesa për të cilat është rritur nga viti në vit. Këshilli Studentor ka luajtur rol aktiv në nxitjen e pjesëmarrjes së studentëve në një sërë nismash humanitare.

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi apo nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë. Universiteti ofron programe studimi në fushat mjekësore në të tre ciklet e studimit në kontekstin e zhvillimit të shërbimeve shëndetësore në rang kombëtar, në përputhje me strategjinë, misionin e tij dhe kërkesat e tregut, si dhe në përputhje me strategjitë përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare, si për shembull me Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë Shqiptare 2016-2020. Në rast propozimi të një programi të ri, personeli përgatit planin e biznesit, të mbështetur në traditat institucionale, planin strategjik, tregun e punës, feedback-un e alumni, infrastrukturën dhe burimet institucionale, si dhe kuadrot ligjorë. Universiteti ka korrur sukses në rritjen e cilësisë së studentëve të regjistruar. Ai ka 28 laboratorë dhe klinika të pajisura me pajisje bashkëkohore, të cilat mbështesin zhvillimin e aftësive dhe kompetencave profesionale, ambiente për të cilat studentët shprehen tejet të kënaqur.

Universiteti harton programe studimi për të lehtësuar mobilitetin e studentëve në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, i cili organizohet në përputhje me Procesin e Bolonjës. Praktika profesionale dhe tezat e diplomave zhvillohen në klinikat dhe laboratorët e universitetit, si dhe në institucione të tjera publike dhe jopublike, si për shembull në Spitalin Universitar të Traumës dhe Spitalin Amerikan në Tiranë. Aktualisht, kualifikimet jashtë vendit mbikëqyren nga 8 anëtarë personeli, gjë që mundëson zhvillimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare, si për shembull të memorandumeve të bashkëpunimit, që janë lidhur me Universitetin e Ferrarës, por vetëm tre anëtarë personeli, të cilët morën pjesë në anketimin e stafit, kanë punuar jashtë vendit në pesë vitet e fundit. Studentëve iu ofrohen mundësi për kryer udhëtime afatshkurtra jashtë vendit, si për shembull për trajnime dyditore në ortodonci dhe kirurgji orale në Itali, si dhe trajnime dyditore në protetike fikse në Gjermani.

Veprimtaritë kulturore dhe arsimore si p.sh konferencat studentore, shkollat verore dhe dimërore dhe kampionatet sportive organizohen në bashkëpunim me Këshillin Studentor. Universiteti komunikon vazhdimisht dhe ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me firmat ndërkombëtare për lehtësimin e punësimit të studentëve, si dhe numri i të diplomuarve të tij që pajisen me licensa është shumë i lartë. Meqenëse të gjitha profesionet e rregulluara kanë detyrimin ligjor të ndjekin edukim të vazhduar për fitimin e krediteve, UAL-ja organizon veprimtari arsimore për personelin, studentët dhe profesionistët në fushat mjekësore përkatëse.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë apo nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandoi universitetit shqyrtimin e mënyrave për sigurimin e pandërprerë të cilësisë dhe standardeve të programeve të tij dhe përmirësimin e mëtejshëm të përvojës së mësimnxënies së studentëve të tij. Programet e studimit mbështeten në kuadrin ligjor, dhe janë në përputhje me planin mësimor, ndërsa përgjegjësitë për organizimin e tyre efikas përcaktohen në rregulloret institucionale. Programet përmbajnë edhe praktika, të cilat zhvillohen brenda universitetit, ose në organizata të tjera publike apo jopublike si p.sh në Spitalin Universitar të Traumës, Spitalin Amerikan të Tiranës dhe në farmaci private, në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara. Universiteti përdor teknologji ndërvepruese për mbështetjen e proceseve të mësimdhënies. Në Planin Strategjik shprehet qartë angazhimi në veprimtari kërkimore. Kërkimi koordinohet nga Njësia Kërkimore Farmakoterapeutike (NJKF), që është pjesë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, dhe Qendrës së Formimit dhe Shërbimit Klinik, që është pjesë e Fakultetit të Shkencave Dentare, dhe që përqendrohet në edukimin në vazhdim dhe shërbimet klinike. Universiteti mbështet fort financiarisht blerjen e pajisjeve laboratorike, si dhe të materialeve



për kërkim shkencor dhe shërbime klinike. Ai nxit bashkëpunimin me universitete të tjera si p.sh. me Akademinë e Shkencave, Universitetin e Mjekësisë në Tiranë dhe me Universitetin e Kietit në Itali. Gjithashtu, ai ka krijuar bashkëpunime të mira të ndërsjella me një sërë biznesesh dhe shoqatash profesionale, si dhe organizon konferenca shkencore studentore dhe boton "Periodikun Shqiptar të Shkencave Biomjekësore". Angazhimi i universitetit në kërkim shkencor është i dukshëm, veçanërisht në lidhje me botimet dhe ndjekjen e konferencave, megjithëse kërkimi ndërmerret kryesisht nga persona, të cilët nuk kanë prioritet kërkimore të mirëpërcaktuara dhe jo nga grupe, gjë që Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si dobësi. Si rrjedhojë, ai i rekomandon universitetit identifikimin e sinergjive ndërmjet anëtarëve aktivë të personelit për krijimin e një numri të vogël grupesh të mirëpërcaktuara kërkimore, që ndjekin objektiva të mirëpërcaktuara dhe afatgjata kërkimore.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi apo nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë. Kriteret e pranimit përcaktohen në Statutin e Universitetit, të cilat marrin pëlqimin dhe miratohen çdo vit nga Senati Akademik. Universiteti monitoron rezultatet e studentëve të rinj dhe synon rritjen e cilësisë së tyre. Aktualisht, në universitet ndjekin studimet 41 studentë të huaj nga Kosova, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi dhe Turqia. Universiteti ndjek një politikë zyrtare për orientimin e studentëve dhe në katalogun e studentëve ofrohen informacione të hollësishme për pranimet dhe orientimin. Ekzistojnë edhe rregullore për funksionimin e sistemit të tutorimit, dhe studentët e vlerësojnë përzemësisht mbështetjen e ofruar nga tutorët. Pavarësisht se ofron disa ambiente sportive, universiteti pranon në Planin e tij Strategjik pamjaftueshmërinë e ambienteve aktuale, dhe pavarësisht organizimit të veprimtarive sportive nga ana e Këshillit Studentor, studentët shprehën nevojën për shtimin e mundësive të ofruara për të marrë pjesë në sporte ekipore.

Ai ka dy biblioteka, që përmbajnë tekste në gjuhën shqipe dhe të huaj në disiplinat përkatëse mjekësore, ku studentët dhe personeli kanë akses shtesë në bibliotekën e pasur mjekësore online. Studentëve iu ofrohet mbështetje nga punonjësit e bibliotekës dhe teknologjisë së informacionit për zhvillimin e aftësive në përfundimin e informacioneve. Universiteti përdor mjedisin virtual të mësimnxënies, që është i disponueshëm si aplikacion në telefon, për lehtësimin e komunikimit midis tutorëve akademikë dhe studentëve, si dhe për t'i drejtuar këta të fundit te burimet që mbështesin mësimnxënien e tyre, gjë që konsiderohet nga studentët si një mënyrë e rëndësishme komunikimi. Këshilli Studentor e ushtron funksionin e tij brenda kuadrit ligjor zyrtar. Përfaqësuesit e studentëve zgjidhen çdo dy vjet dhe janë përgjegjës për dhënien e sugjerimeve lidhur me çështje akademike si p.sh me planet mësimore dhe politikën për veprimtaritë e studentëve. Universiteti ofron mbështetje financiare për veprimtari kulturore, shkencore apo në raste festash si p.sh për shkolla verore dhe dimërore, apo konferenca shkencore. Përgjegjëse për mbështetjen e studentëve dhe alumni për punësim është Zyra e Këshillimit të Karrierës. Universiteti ka lidhur një sërë marrëveshjesh me kompani vendase dhe ndërkombëtare për ofrimin e stazheve, si dhe ka nënshkruar një marrëveshje me një kompani për mbështetjen e infermiereve që kërkojnë punë në Gjermani.

Në arritjen e këtyre gjykimeve, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë, të cilën universiteti dëshiron jo vetëm ta zhvillojë më tej, por edhe ta përhapë në sektorin e arsimit të lartë shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandoi universitetit shqyrtimin e mënyrave për sigurimin e pandërprerë të cilësisë dhe standardeve të programeve, si dhe për përmirësimin e mëtejshëm të përvojës së studentëve të tij.

Universiteti e ndërmori vetëvlerësimin në përputhje me udhëzimet e APAAL-it. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson shkallën e angazhimit të universitetit në proces dhe bashkëpunimin e tij përgjatë fazës së vizitës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga Znj. Penny Renwick (Kryetare), Prof. Dr. Anila Hoda dhe Prof. Jeremy Bradshaw (Anëtarë).

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimin se Standardet e Cilësisë janë përmbushur plotësisht në katër fusha dhe kryesisht në një fushë.

## Përmbledhje e gjetjeve

### Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- qasja sistematike e universitetit në ndjekjen e përfundimeve të Raportit të Vlerësimit të Jashtëm dhe të ecurisë lidhur me objektivat strategjike (pika 1.5; **Kapitulli III Standardi I.5**).

### Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- kërkimi shkencor ndërmerret kryesisht nga persona, të cilët nuk kanë përparësi kërkimore të mirëpërcaktuara dhe jo nga grupet (pika 4.9; **Kapitulli II Standardi I.5**).

### Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm, i cili duhet zbatuar brenda 12 muajsh:

- ndërmarrja e masave të nevojshme dhe nxitja e bashkëpunimit në ndjekjen e përparësive të mirëpërcaktuara kërkimore institucionale (pika 4.9; **Kapitulli II Standardi I.5**).

### Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë.

### Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht**.
- 2 Standardet për Burimet janë përbushur **plotësisht**.
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht**.
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht**.
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**.

### Gjykim i përmbledhur

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Universitetin "Aldent", Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përbushur plotësisht**.

## Raporti i detajuar

### Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 Universiteti organizohet, përbëhet dhe drejtohet në përputhje me ligjin “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin dhe rregulloret e tij. **[RVV fq.7; 1.1; 3.0]** Ai përbëhet nga dy fakultete: Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Fakulteti i Shkencave Dentare. **[RVV fq.8; 1.3]** Organika e universitetit është miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit me Urdhrin Nr. 305, datë 24/07/2013.**[1.3]** Senati Akademik, Këshilli i Etikës dhe këshillat e fakulteteve e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me statutin dhe rregulloret e institucionit. Secili prej tyre i nënshtrohet kontrolleve periodike për monitorimin e efikasitetit dhe identifikimin e përmirësimeve të mundshme.**[RVV fq.9; 29.0; 29.2]** Janë hartuar plane për ristrukturimin e universitetit në tre fakultete, ku parashikohet shtimi i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, të cilat janë miratuar së fundmi nga MAS-i me Urdhrin Nr. 115, datë, 13.03.2017.**[1.4] [Kapitulli III Standardi I.1]**
- 1.2 Universiteti organizohet në mënyrë të tillë që të sigurohet efikasitet në drejtim. Strukturat drejtuese përfshijnë Senatin Akademik, Këshillin e Etikës dhe Këshillat e Fakulteteve.**[1.1]** Senati Akademik, i kryesuar nga Rektori, është organi kolegjal më i lartë vendimmarrës, i cili përcakton strategjinë dhe politikën, **[2.0]** koordinon veprimtaritë mësimdhënëse dhe kërkimore, si dhe vlerëson efikasitetin e tyre. **[1.1]** Këshilli i Etikës është një strukturë e përhershme e universitetit, që diskuton dhe i paraqet propozime Rektorit për çështje lidhur me etikën e jetës universitare.**[1.1 neni 7; 6.0]** Rektorati është këshilli ekzekutiv i universitetit.**[RVV fq.9]**Këshilli Studentor bashkëpunon me universitetin për sigurimin e përfaqësimit të studentëve në komisione, duke përfshirë edhe në Senatin Akademik, **[1.1; EA.1; M2; M3; M4]** interesat e të cilëve mbështeten nga njëri prej anëtarëve të komisionit përkatës. **[M3]** Këshillat e Fakulteteve përbëhen nga Dekani, përgjegjësit e departamenteve, profesorët, profesorët e asociuar, doktorët dhe një përfaqësues të studentëve.**[RVV fq.9; 1.1][Kapitulli III Standardi I.2]**
- 1.3 Universiteti nxit debatin konstruktiv ndërmjet anëtarëve të personelit dhe studentëve. Senati Akademik mbledhet rregullisht dhe ofron një forum për debatin akademik. Rendi i ditës së çdo mbledhjeje përgatitet nga Rektorati dhe iu shpërndahet të gjithë anëtarëve paraprakisht. Diskutimi është gjithëpërfshirës, i hapur dhe konstruktiv.**[4.0; 4.1; 4.2; M3]**.Universiteti i vlerëson mendimet e studentëve dhe i përgjigjet feedbackut të tyre.**[M1; M2]** Përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e vendimeve të Senatit Akademik janë Rektori dhe Dekanët.**[4.1]** Edhe organet drejtuese si Këshilli i Etikës, këshillat e fakulteteve dhe Këshilli Shkencor organizojnë debate konstruktive.**[9][Kapitulli III Standardi I.3]**
- 1.4 Rektori ngre grupet e auditimit, të cilëve iu kërkohet të kontrollojnë veprimtarinë akademike dhe administrative të universitetit. Raporti përmbyllës i paraqitet Rektorit. Grupi i auditimit është i pavarur dhe ndihmon në sigurimin e ushtrimit të kompetencave të strukturave përbërëse të universitetit, në përputhje me autonominë që gëzojnë me Statut.**[29.0; 29.2; 29.2.1; 37.3]** Universiteti ka ngritur edhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), në përputhje me kuadrin ligjor për arsimin e lartë. Kjo njësi e pavarur është përgjegjëse për vlerësimin dhe hartimin e raporteve lidhur me cilësinë dhe efikasitetin e veprimtarive mësimdhënëse, kërkimore dhe administrative.**[RVV fq.10; 7.0; 7.1; 7.2; M2; M3][Kapitulli III Standardi I.4]**
- 1.5 Në Planin Strategjik të Universitetit, që u hartua në vijim të diskutimeve me autoritetet dhe organet drejtuese, si dhe të konsultimeve me stafin akademik,

personelin administrativ dhe studentët, përcaktohen qëllimet e universitetit, të cilat janë: rritja e cilësisë së mësimdhënies, rritja e kapaciteteve akademike, përmirësimi i infrastrukturës, nxitja e ndërmarrjes së kërkimeve shkencore nga ana e personelit dhe studentëve, si dhe diversifikimi i burimeve financiare. **[RVV fq.10-11; 2.0; 2.1.1]** Rektorati dhe Senati monitorojnë ecurinë e universitetit lidhur me objektivat strategjike, hartojnë planet e veprimit, duke përfshirë afatet dhe treguesit kyç të performancës për çdo pjesë të planit, dhe caktojnë një anëtar personeli si përgjegjës për çdo detyrë. Universiteti përdor të njëjtën qasje për t'iu përgjigjur rekomandimeve të raporteve vjetore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe të Raporteve të Vlerësimit të Jashtëm të akreditimit. Në secilin prej rasteve, ai identifikon veprimet, përcakton përgjegjësitë dhe afatet, si dhe ndjek dhe raporton ecurinë **[M3; FE1; EA1-3]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi qasjen sistematike të universitetit për ndjekjen e përfundimeve të Raportit të Vlerësimit të Jashtëm dhe të ecurisë lidhur me objektivat strategjike si karakteristikë të praktikës së mirë, në përputhje me standardin 1.1 të Standardeve dhe Udhëzimeve Evropiane: "Institucionet duhet të ndjekin një politikë për sigurimin e cilësisë, e cila duhet bërë publike dhe të përfshihet në drejtimin strategjik". Palët e brendshme të interesit duhet ta zhvillojnë më tej dhe ta zbatojnë këtë politikë përmes strukturave dhe proceseve të përshtatshme, duke përfshirë edhe palët e jashtme të interesit. **[Kapitulli III, Standardi I.5]**

- 1.6 Raportet vjetore të MAS-it analizojnë performancën e universitetit dhe paraqesin veprimtaritë akademike dhe administrative të vitit të mëparshëm akademik. Raporti mbështetet në raportet e brendshme të çdo njësie të universitetit. NJSBC-ja mbështet hartimin e raporteve të njësive, duke ofruar të dhënat dhe materialet përkatëse. Projektraportet diskutohen në Këshillin e Fakultetit. Secili Dekan ia paraqet fillimisht raportet e fakultetit Rektoratit, të cilat shërbejnë si bazë për raportin në shkallë universiteti, dhe më pas ia paraqet për miratim Senatit Akademik. **[RVV fq.11; 3.1; M7]** Raporti përfundimtar i dërgohet ministrisë dhe publikohet në faqen e internetit të universitetit. **[<http://www.ual.edu/en/about-ussr/reports/>; M4]**. Rektorati shqyrton përgjigjen e MAS-it dhe harton planin e veprimit, i cili shqyrtohet dhe miratohet më pas nga Senati Akademik. **[EA1-3; FE1; M2]** **[Kapitulli III Standardi I.6]**
- 1.7 Siç konstatohet edhe më sipër, struktura drejtuese e universitetit është e përshtatshme dhe efikase, duke mundur përmbushjen e misionit, vizionit dhe objektivave të tij. Universiteti drejtohet si subjekt i pavarur ligjor, i cili i merr vetë vendimet lidhur me veprimtaritë e tij akademike dhe administrative. Krahas strukturave drejtuese, universiteti ka një sërë njësish administrative, duke përfshirë: Zyrën e Programeve të Studimit, Zyrën e Këshillimit të Karrierës, Njësine të Sigurimit Brendshëm të Cilësisë, Sekretarinë Mësimore, Zyrën e Financës dhe IT-së, Zyrën e Informacionit dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore. **[1,3][Kapitulli III Standardi II.1]**
- 1.8 Statuti dhe rregulloret e universitetit përcaktojnë qartësisht organizimin dhe funksionimin e bordeve dhe komisioneve të ndryshme, që lehtësojnë dhe ofrojnë forumet e debatit dhe vendimmarrjeve. **[RVV fq.11; 1.1; 3.0; 8.0]** Bordet i ofrojnë mundësinë personelit të japin kontributin e tyre në debatet konstruktive dhe proceset vendimmarrëse të universitetit. **[5.0; 5.1; 5.2; 8.1]** Çdo bord, ka në përbërje një përfaqësues të studentëve. **[1.1]** Këshilli Studentor funksionon si njësi që gëzon autonomi të plotë në parashtrimin e mendimeve të studentëve në proceset vendimmarrëse të universitetit. **[17.0; 17.1; 17.2]** Personeli dhe studentët pohojnë marrjen në konsideratë të mendimeve të tyre nga ana e universitetit gjatë proceseve vendimmarrëse. **[M3; M4; M5; M7][Kapitulli III Standardi II.3]**
- 1.9 Duke qenë se programet e studimit lidhen me profesionet e rregulluara, universiteti merr informacione edhe nga organizatat profesionale, që mbledhin të dhëna për

licensimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së tyre profesionale. **[26.2; 26.3; M2; M6]** Gjatë hartimit të programeve të reja të studimit, universiteti merr parasysh tregun e punës në sektorin e mjekësisë. **[11.2.1; 11.3; M6]** Për shembull, rezultatet e studimit të tregut dhe anketimit të mjekëve, treguan se ka mungesë të specialistëve të fushës së kirurgjisë orale dhe ortodoncisë, gjë që solli krijimin e një programi afatgjatë në këto fusha specializimi dentare. **[11.2]** Universiteti ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me agjencitë e punësimit për ofrimin e formimit, këshillimit dhe llojeve të tjera të ndihmës rreth punësimit në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. **[41.1.2][Kapitulli III Standardi III.1]**

- 1.10 Në Strategjinë e universitetit përcaktohen prioritetet e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit. **[2.0]** Universiteti ka lidhur edhe një sërë marrëveshjesh me disa institucione mjekësore dhe arsimore, si dhe me institucione të tjera joakademike. **[41.1]** Këto partneritete, ofrojnë mundësi për formim praktik, bashkëpunim shkencor dhe organizimin e veprimtarive të përbashkëta. **[43.0]** Gjithashtu, janë lidhur marrëveshje me qendra spitalore, spitale jopublike dhe institucione joakademike, si p.sh me Spitalin Universitar të Traumës në Tiranë, Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza dhe Spitalin Amerikan të Tiranës, për t'i ofruar studentëve stazhe. **[41.1]** Universiteti ka krijuar edhe partneritete me organizatat jofitimprurëse, ku përfshihet ofrimi i kujdesit dentar falas për ata persona, që nuk janë në gjendje ta paguajnë. **[24.0; 24.1]** Ai i fton pedagogët e vendeve të tjera, të cilët shquhen në fushat e tyre përkatëse, të mbajnë leksione në universitet **[42.3]** dhe ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi, që mundësojnë angazhimin e personelit dhe studentëve në shkëmbime në shkallë ndërkombëtare. **[41.1; 42.0; 42.3][Kapitulli III Standardi III.2]**
- 1.11 Universiteti bashkëpunon me një sërë institucionesh në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe ka lidhur marrëveshje me programet 3M-ESPE, YETI dhe Vita. Partnerët vendorë përfshijnë spitalet dhe klinikat mjekësore në Tiranë, ku studentët kryejnë stazhin. **[41.1; M2]** Universiteti bashkëpunon edhe me Shoqatën Dentare Shqiptare, Shoqatën e Ortodontëve Shqiptarë, Shoqatën e Kirurgëve Oralë dhe Maksilofacialë Shqiptarë dhe shoqëritë private. **[41.1; M2; M6]** Strategjia e universitetit përfshin përfitimin e financimeve të mëtejshme nga programet evropiane dhe aktualisht, universiteti ka aplikuar për disa projekte ndërkombëtare. **[RVV fq.10; 38.0; 41.3; M1][Kapitulli III Standardi III.3]**
- 1.12 Universiteti ofron mobilitet ndërkombëtar për stafin akademik dhe studentët. Çdo vit, universiteti pranon disa studentë ndërkombëtarë **[EA1-5.2; FE1-5.1]** dhe ofron mobilitet për stafin e tij akademik dhe studentët si në shkallë kombëtare, ashtu edhe në shkallë ndërkombëtare. Studentët ndërkombëtarë u shprehën se universiteti e lehtëson transferimin e tyre përmes periudhave orientuese dhe integruese. **[M4; M5]** Ai organizon konferenca ndërkombëtare dhe ofron mbështetje financiare për anëtarët e stafit akademik dhe studentët, që dëshirojnë të marrin pjesë në veprimtari ndërkombëtare. **[2.0; 5.0; M4; M4].** Studentëve dhe stafit akademik iu ofrohet mundësia të vizitojnë universitete të tjera, me të cilat Aldenti ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. **[16; M4]** Studentët e transferuar nga Qiproja, Italia dhe Kanadaja u shprehën se procesi i njohjes së studimeve të tyre të mëparshme ishte i ndërlikuar, por që personeli i universitetit i kishte ndihmuar. **[M4][M7]** Universiteti vizitohet shpesh nga personeli i institucioneve të tjera, duke përfshirë specialistë të fushave të ndryshme apo edhe vizitorë nga Evropa, Amerika dhe Azia. **[41.2; 41.2.1; 41.2.2; 13; 42.3; FE8.2]** Personeli është angazhuar edhe në shkëmbime. **[FE8.3; M8]** Universiteti ka bashkëpunuar me disa shoqëri nga Lubjana, Sllovenia, Gjermania, Firencja dhe Italia lidhur me veprimtaritë arsimore. **[RVV Dok 41.2].** Personeli dhe studentët kanë marrë pjesë në Shkollën Mjekësore Veriore të Dragashit, në Kosovë; Shkollën Mjekësore Dimërore të Ulqinit, në Mal të Zi; dhe në Shkollën Mjekësore

Vjeshtore të Lefkadës, në Greqi.[42.0; 39.1] Universiteti është duke lidhur marrëveshje me universitetet partnere për mundësimin e shkëmbimit të doktorantëve, si dhe ka lidhur tashmë marrëveshje me Universitetin e Kietit dhe të Ferrarës.[FE8; M8] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi vështirësitë e qenësishme në mobilitetin e studentëve për programet klinike, për shkak të kërkesës për kurrikula plotësuese dhe vlerëson punën e pareshtur të universitetit për përafrimin e kurrikulës së tij me standardet evropiane [ 40,0 ]. Megjithëse mobiliteti i personelit dhe studentëve të ciklit të tretë është i suksesshëm, universiteti pranon punën e mëtejshme që duhet bërë në angazhimin e personelit dhe studentëve të tij në veprimtari ndërkombëtare. [RVV fq.17; M7][Kapitulli III Standardi III.4]

## **Gjetje**

### **Praktika e mirë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- qasja sistematike e universitetit në ndjekjen e përfundimeve të Raportit të Vlerësimit të Jashtëm dhe të ecurisë lidhur me objektivat strategjike (pika 1.5; **Kapitulli III Standardi I.5**).

### **Dobësitë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

### **Rekomandime**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

### **Pohimi i veprimeve të ndërmarra**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

## **Gjykimi**

**Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.**



## Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 Universiteti ndjek një politikë të hapur për rekrutimin dhe punësimin e stafit, dhe i identifikon nevojat për anëtarë shtesë të stafit akademik përpara fillimit të çdo viti akademik. **[20; 20.1]**. Ai i shpall vendet e lira të punës përmes disa kanaleve, duke përfshirë edhe faqen e internetit të universitetit [\[http://www.ual.edu.al/sq/studentet/maturantet\]](http://www.ual.edu.al/sq/studentet/maturantet), rrjetet e tij sociale zyrtare, zyrën e informacionit, seksionit të posaçëm në faqen e internetit, [\[http://www.ual.edu.al/en/employment-opportunities/\]](http://www.ual.edu.al/en/employment-opportunities/) dhe kontakteve të drejtpërdrejta. **[RVV fq.17; 42.3]** Politika e punësimit dhe rekrutimit të personelit është transparente, në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”. **[RVV fq.17; 18.0; 18.2; 18.4; 18.5; 18.6]** Punësimi i anëtarëve të stafit akademik dhe personelit administrativ bëhet në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit, kriteret e përzgjedhjes së të cilës përcaktohen nga Senati Akademik. **[18.0; 18.1]** Gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të stafit akademik, i jepet përparësi përvojës profesionale, e cila ndiqet nga reputacioni, përvoja dhe aftësitë pedagogjike, kualifikimet akademike dhe dosja e punimeve shkencore. **[19.3; 19.4]** Universiteti synon veçanërisht rekrutimin e stafit të kualifikuar, që janë diplomuar dhe kualifikuar në universitetet e MB-së, Italisë, Zvicrës, Japonisë, Republikës Çeke dhe Francës. **[42.3]** Aplikimet i paraqiten Zyrës së Burimeve Njerëzore **[18.0]**, të cilat vlerësohen dhe më pas renditen sipas kriterëve përkatëse nga komisioni i posaçëm i vlerësimit, i ngritur nga universiteti. **[18.3][Kapitulli III Standardi IV.1]**
- 2.2 Integrimi i stafit akademik, asistent mësimor, shkencor dhe personelit administrativ arrihet përmes disa veprimtarive gjithëpërfshirëse, që përfshijnë ditët e informimit, ditët e orientimit, studentët, mundësitë e trajnimit, seminarët, leksionet e hapura dhe konferencat. **[RVV fq.18; 26.0; 34.1; 39.0; 13.0; 42.4; 43.0]** Ekzistojnë edhe politika për personelin, që nxisin integrimin dhe dhënien e mendimeve të tyre rreth zhvillimit institucional. **[2.1.1]** Këto mundësi dhe politika janë njësoj të zbatueshme edhe për stafin akademik të jashtëm, të cilët nxiten të marrin pjesë në kërkime shkencore dhe veprimtari sociale, si dhe në ceremonitë e universitetit si p.sh hapja dhe mbyllja e vitit akademik, ceremonia e diplomimit dhe festa e Krishtlindjes. [\[http://www.ual.edu.al/sq/galeria-3/aktivitete-te-ndryshme,](http://www.ual.edu.al/sq/galeria-3/aktivitete-te-ndryshme) [http://www.ual.edu.al/sq/sample-page/trajnime-shkencore\]](http://www.ual.edu.al/sq/sample-page/trajnime-shkencore) Universiteti ndihmon dhe nxit stafin akademik për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme profesionale dhe botimin e punimeve shkencore, duke ofruar informacionet, infrastrukturën, logjistikën dhe kontaktet përkatëse. **[RVV fq.19, M8][Kapitulli III Standardi IV.2]**
- 2.3 Ai nxit politikën e vlerësimit të aftësive dhe shprehive të personelit të tij, bazuar në përshkrimet e çdo pozicioni pune, të miratuara nga Senati Akademik. **[RVV fq.20; 18.1; 18.2; 18.3.1]** Kriteret e vlerësimit përfshijnë mësimdhënien, administrimin dhe kërkimin **[20.0; 20.1; M8]**. Në çdo vlerësimin vjetor, përfshihen pyetësorët përkatës të studentëve, analiza e pikëve në kategori të ndryshme, raporti i performancës dhe raporti që i dorëzohet Rektorit. **[FE2; M7; M8][Kapitulli III Standardi IV.3]**
- 2.4 Universiteti nxit zhvillimin social të personelit dhe studentëve të tij përmes një larmie nismash duke përfshirë: ditët e dhurimit të gjakut; ditët kushtuar ndërgjegjësimit rreth sëmundjeve si autizmi, hemofilia, diabeti dhe hipertensioni; ndihmë në raste fatkeqësish natyrore; ndihmë për shtëpitë e fëmijës; ofrimi i shërbimeve dentare falas për pensionistët; shkolla verore dhe dimërore; si dhe kontrole mjekësore falas. **[17.3; 34.7; 39.1; 43.0; <http://www.ual.edu.al/en/students/3858-2>;** [http://www.ual.edu.al/sq/galeria-3/aktivitete-te-ndryshme/aktiviteti-dhuroni-gjak;](http://www.ual.edu.al/sq/galeria-3/aktivitete-te-ndryshme/aktiviteti-dhuroni-gjak) **M3; M5; turi në terren]. [Kapitulli III, Standardi IV.4]**

- 2.5 Statuti dhe rregulloret e universitetit përcaktojnë qartësisht vartësinë hierarkike dhe ndarjen e përgjegjëse të personelit të tij. **[1.1; 18.0]** Në të gjithë universitetin, përdoret një strukturë raportuese drejtvizore. Të gjithë personat janë të informuar për të drejtat e tyre, detyrat dhe ndërvarësinë institucionale. **[RVV fq.29; 18.4; 18,5; 18,6; 18.7; 18.2]** **[[Kapitulli III, Standardi II.2]**
- 2.6 Universiteti e harton buxhetin vjetor në përputhje me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e tij të Zhvillimit. **[28.0; 28.1]** Përgjegjëse për përgatitjen e projektbuxhetit është Zyra e Financës, në bashkëpunim me Kancelarin. **[29.1.1; M3]** Universiteti i shpërndan burimet financiare në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Rektorati, të cilat, nga ana tjetër, bazohen në nevojat dhe sugjerimet e çdo njësie bazë apo kryesore. **[28.0; 28.1]** Departamentet mund të kërkojnë financim shtesë për mjetet dhe materialet mjekësore, projektet kërkimore, konferencat shkencore, botimet dhe veprimtaritë formuese. **[34.1; 34.3; M3]** Kancelari ia paraqet projektbuxhetin Senatit për miratim përfundimtar. **[28,0]** **[[Kapitulli III Standardi VI.1]**
- 2.7 Përgjegjëse për menaxhimin dhe zbatimin e politikave financiare është Zyra e Financës. **[1.1; 1.2; 34.0; M3]** Ajo i përgatit pasqyrat financiare vjetore në përputhje me kuadrin e kontabilitetit, të përshkruar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Qendra Kombëtare e Biznesit i publikon raportet në faqen e saj zyrtare të internetit. <http://www.qkr.gov.al/search/search-in-trade-register/search-for-subject> **[[Kapitulli III Standardi VI.2]**
- 2.8 Si shoqëri e regjistruar, universiteti harton pasqyra financiare vjetore si p.sh bilancin, pasqyrën e performancës (pasqyrën e të ardhurave), pasqyrën e xhimit të parave, dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto. Secila prej këtyre pasqyrave i nënshtrohet një auditi të pavarur. **[29.0; 29.1; 29.1.1]** Universiteti ia paraqet raportet e tij financiare Senatit Akademik dhe të gjithë personelit, përmes një mbledhjeje të posaçme. Bilanci vjetor publikohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me detyrimet ligjore të universitetit <http://www.qkr.gov.al/search/search-in-trade-register/search-for-subject> **[[Kapitulli III Standardi VI.3]**
- 2.9 Sistemet e informacionit të universitetit janë të koordinuara për të mundësuar shkëmbimin e informacionit dhe aksesin e çdo personi të autorizuar. Analiza e të dhënave shërben si bazë për vendimmarrjen dhe i jep formë zhvillimit strategjik të universitetit **[2.0; 31.0; M3; M8]** Universiteti ka një platformë online për administrimin institucional, i cili përbëhet nga disa module. Modulet e studentëve i japin mundësinë çdo studentit të kontrollojë në llogarinë e tij/saj personale kurset në të cilat është regjistruar. Moduli i shërbimit të universitetit menaxhon bazën e të dhënave të modulit të studentëve duke paraqitur notat e tyre, rezultatet, kurset ku janë regjistruar, njoftimet dhe informacione të tjera. Gjithashtu, ekziston një modul për korrespondencën institucionale, si dhe një modul financiar. **[31.0]** Sistemi mund të përdoret për ofrimin e raporteve të ndryshme, si p.sh të përmbledhjeve të performancës, frekuentimit apo ecurisë së studentëve. Në faqen zyrtare të internetit të universitetit <http://www.ual.edu.al/en/home> publikohen të dhënat rreth numrit të studentëve për çdo program studimi, ofertës akademike, kurrikulës, kërkesave specifike për çdo program studimi, si dhe organika, ekstrakte nga Statuti dhe rregulloret e universitetit. **[45.0]** Faqet zyrtare të rrjeteve sociale administrohen nga Zyra e Informacionit dhe përfaqësuesit e Këshillit Studentor. <https://www.facebook.com/Universiteti-Aldent-Faqja-Zyrtare-187619367967493/?fref=ts>; <https://www.instagram.com/ksualdent> **[[Kapitulli III, Standardi VII.1]**
- 2.10 Veprimtaritë e universitetit në fushën e teknologjisë së informacionit janë të koordinuara.

Ai i ofron stafit akademik dhe studentëve të tij akses në intranet dhe internet. Disa prej laboratorëve janë të pajisura me kompjuterë dhe printera, përmes së cilave studentët mund të aksesojnë faqen e internetit të universitetit dhe të hyjnë në llogaritë e tyre personale.**[33.0]** Ekzistojnë edhe portali i studentëve dhe sistemi i menaxhimit të mësimdhënies, përmes të cilave personelit dhe studentëve iu ofrohet akses në rezultatet e provimeve, leksioneve online dhe materialeve të tjera lidhur me programet e studimit.**[33; M4; M5; turi në terren]** Bibliotekat janë të pajisura me kompjuterë, në mënyrë që studentëve të kenë akses edhe në bibliotekën online të universitetit, si dhe në burime të tjera online.**[12.0; 12.1; 45.0; turi në terren][Kapitulli III Standardi VII.2]**

- 2.11 Universiteti i menaxhon dhe i dokumenton pronat e paluajtshme në përputhje me kërkesat ligjore aktuale.**[RVV fq.24; 33; 33.1]** Ambientet dhe infrastruktura i përmbushin standardet më të larta dhe mirëmbahen për sigurimin e funksionimit të plotë dhe ofrimin të kushteve të nevojshme.**[33.5; 33.4; 33.5]** Së fundmi, universiteti e ka zgjeruar infrastrukturën përmes blerjes së një godine të re në vitin 2014-2015 **[33.1]**, gjë e cila kërkon rritjen e numrit të anëtarëve të personelit mbështetës dhe të mirëmbajtjes.**[RVV fq.24]** Plani Strategjik i Universitetit për periudhën 2016-2020, synon ndërtimin e një kampusi universitar modern në një qendër rezidenciale të Tiranës. Megjithëse i gjithë ky projekt është vetëm në fazat e para, Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu ofrua planimetria të ambienteve të reja të propozuara.**[33.1.1]** Kampusi i ri do të ofrojë ambiente sportive, të cilat aktualisht mungojnë.**[RVV fq.54-55; M4][Kapitulli III Standardi VII.3]**
- 2.12 Universiteti ndjek një politikë për mirëmbajtjen edhe zhvillimin në vazhdim të trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore.**[19.0; 19.3; 19.4]** Universiteti ka edhe një arkivë të veçantë dokumentesh.**[32.0]** Ruajtja e dokumenteve bëhet në përputhje me kuadrin përkatës ligjor dhe rregulloret e brendshme për ruajtjen e tyre. Dosjet e studentëve arkivohen nga Sekretaria, ndërsa dosjet personale të veprimtarisë akademike dhe kërkimore të çdo pedagogu me kohë të plotë arkivohen nga departamentet.**[32.1; 32.2]** Të gjitha përfundimet e veprimtarisë kërkimore të stafit akademik ruhen në bibliotekën e universitetit.**[12.1]** Në bibliotekë, gjenden edhe disa tekste të vjetra, të cilat pavarësisht vlerës së tyre historike, mund t'i çorientojnë studentët me informacionet që ofrojnë, prandaj do të ishte mirë që universiteti të shqyrtonte mënyrat e trajtimit të kësaj pike.**[vizita në terren][Kapitulli III Standardi VII.4]**
- 2.13 Infrastruktura e universitetit është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për qëllimet arsimore dhe kërkimore, si dhe veprimtaritë administrative dhe sociale.**[33.0; 33.1; 34.6; vizita në terren]** Përshtatshmëria e infrastrukturës u konfirmua nga studentët e të tre cikleve ose programeve.**[M4; M5][Kapitulli III Standardi VII.5]**
- 2.14 Universiteti ofron një sërë shërbimesh në përputhje me nevojat e komunitetit vendas, ku përfshihet ofrimi i shërbimeve dentare falas për grupet e cenueshme si të papunësuarit, pensionistët, dhe gratë që kanë përjetuar dhunë në familje, **[2.0; 24.0; 34.0; M1; M3; M7; vizita në terren]** kërkesa për të cilat është rritur nga vit në vit. **[24.1]** Këshilli Studentor nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve në nisma humanitare si p.sh në mbledhjen e fondeve në bamirësi për fëmijët e zonave rurale, dhe bashkërendimin e ditëve të informimit për kancerin, HIV-in, diabetin dhe dhurimin e gjakut. Universiteti i mbështet këto aktivitete ose financiarisht, ose përmes ofrimin të burimeve njerëzore.**[RVV fq.25; <http://www.ual.edu.al/en/students/students-group/17.0>; 17.3][Kapitulli III Standardi VII.6]**
- 2.15 Universiteti ka tre godina për veprimtaritë akademike dhe kërkimore, të cilat i përmbushin të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj dhe udhëzimet

përkatëse, dhe janë të pajisura në përputhje me standardet më të larta. **[RVV fq.26; 33.2; 33.3; vizita në terren]** Dy prej godinave ndodhen në qendër të Tiranës, ndërsa godina më e re ndodhet në periferi të qytetit. **[Vizita në terren]** Transporti nga njëra godinë në tjetrën bëhet i mundur përmes një autobusi të posaçëm vajtje-ardhje. **[34.0; 34.2.1]** Universiteti ka 19 salla leksionesh, nëntë auditorë dhe 28 laboratorë gjithsej, të cilët ofrojnë kushte të përshtatshme për procesin e mësimdhënies. Të gjitha sallat e leksioneve janë të pajisura me mjete audio-vizuale si kompjuterë, videoprojektorë dhe tabela mësimore. Laboratorët kanë pajisjet e nevojshme për kurrikulën. **[23.0; 33.0; 40.0; 34.6]** Godinat me kapacitet më të lartë kanë dy palë shkallë, njëra prej të cilave ofron dalje në rast emergjencash. **[33.1]** Të gjitha godinat janë të pajisura me alarme zjarri dhe me të gjitha mjetet e nevojshme në rast zjarri dhe mbrojtje kundër shkarkimeve elektrike. **[33.3]** Ata kanë edhe gjeneratorë për prodhimin e energjisë elektrike dhe depozita uji për sigurimin e energjisë elektrike dhe furnizimit me ujë. Të gjitha godinat e universitetit kanë kamera sigurie, të cilat monitorojnë gjatë orëve të mësimit. **[RVV fq.26; vizita në terren]** Universiteti ka gjashtë klinika dentare me 28 njësi dentare, ku studentët praktikohen nën mbikëqyrjen e profesorëve të tyre. **[<http://www.ual.edu.al/en/gallery/dental-laboratory/classes-laboratory/>; 24.0]** Për ofrimin e stazheve profesionale, universiteti ka lidhur marrëveshje me një sërë institucionesh shëndetësore dhe dentare, si dhe me disa farmaci. **[41.1; 15.0; 15.1; 15.2]**. Studentët shprehen të kënaqur me ambientet dhe burimet e mësimnxënies, duke përfshirë edhe sistemin e menaxhimit të mësimnxënies. Ata shprehen se bibliotekat janë të pasura në tituj, megjithëse parapëlqejnë të përdorin më tepër literaturën online. **[M4][Kapitulli III Standardi V.1]**

- 2.16 Universiteti i ruan dokumentet si në format të shtypur, ashtu edhe në format elektronik. **[32.0]** Periudha e ruajtjes së dokumenteve të ndryshme përcaktohet nga Senati Akademik. **[32.1; 32.2]** Universiteti i dërgon MAS-it dhe Agjencisë Kombëtare të Provimeve të dhëna të sakta për studentët, personelin dhe institucionin. **[27.5]** Ai mban një regjistër për diplomimin e studentëve, ku shënohet i gjithë informacioni i kërkuar nga udhëzimet e MAS-it. **[21.0; 32,2][Kapitulli III Standardi V.2]**

## **Gjetje**

### **Praktika e mirë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

### **Dobësitë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

### **Rekomandime**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

### **Pohimi i veprimeve të ndërmarra**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë.

## **Gjykimi**

**Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.**

## Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 Universiteti ofron programe studimi në fushat mjekësore në të tre ciklet e studimit, në përputhje me strategjinë, misionin e tij dhe kërkesat e tregut. [RVV fq.28, 1.1; 2.0; 11.0; 40.0; M3] Programet e reja ofrohen në pajtim me kuadrot ligjorë, kërkesat e tregut, infrastrukturën dhe objektivat strategjike. [11.1; 11.2; 11.2.1] Të gjitha programet e studimit janë akredituar nga APAAL-i, me përjashtim të dy programeve të hapura së fundi: Masterit të Shkencave në Fizioterapi dhe programit Bachelor në Teknikë Laboratori Mjekësore. [RVV fq;29; 11.0] Universiteti ka rritur me sukses kriteret e pranimit për studentët aplikantë. [RVV fq.29; 27.0; 27.1; 27.2; M2; M7] Ai i miraton kriteret e pranimit dhe kuotat në përputhje me kuadrot e tij ligjorë, [25.0; 25.1; 25.2] ndjek një politikë të veçantë, e cila monitorohet nga MAS-i, për studentët në nevojë financiare dhe grupet e marginalizuara, si dhe ka caktuar kuota për minoritetet etnike dhe studentët ndërkombëtarë. [RVV fq.29; 25.3] Universiteti e publikon informacionin rreth programeve të tij të studimit përmes fletëpalosjeve, katalogut të studentëve, shtypit të shkruar dhe televizioneve. [40; 44.1; 44.2] Në anketimin e studentëve, mbi 69 për qind e tyre raportuan se universiteti i ka përmbushur pritshmëritë e tyre që prej çastit të regjistrimit. [Anketimi i Studentëve] Në vijim të ndryshimeve ligjore dhe kërkesave të MAS-it, universiteti ka përmirësuar politikën e informimit rreth programeve të studimit dhe kriteret e pranimit për gjimnazistët e diplomuar. [RVV fq.29;26.0; 26.1] Gjatë dy viteve të fundit, universiteti ka bashkëpunuar me Agjencinë Kombëtare të Provimeve dhe me “Albanian University” për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të ciklit të parë. [RVV fq.29; <https://www.youtube.com/watch?v=7cu06w03bcE>] Për vlerësimin e aplikimeve të studentëve, universiteti ndjek një proces zyrtar pikëzimi dhe renditjeje. [RVV fq.30; 27.0; 27.3]. Pranimi i studentëve të ciklit të dytë kryhet nga komisioni i posaçëm i universitetit, duke i vlerësuar aplikimet përmes kriterëve të miratuara nga Senati Akademik dhe të përcaktuara në Statut. [RVV fq.30; 1.2] Pranimi i studentëve të ciklit të tretë bëhet në përputhje me rregulloret e universitetit. [RVV fq.30; 10.3] [Kapitulli I Standardi I.1]
- 3.2 Meqenëse të gjitha profesionet e rregulluara kanë detyrimin ligjor të ndjekin edukim të vazhduar për fitimin e krediteve, UAL-ja organizon veprimtari arsimore për personelin, studentët dhe profesionistët në fushat mjekësore përkatëse. Veprimtaria e edukimit në vazhdim e universitetit, si p.sh kurset një ditore, është akredituar nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim (QKEV). Dokumentacioni përgatitet nga Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike dhe Qendra e Shërbimit dhe Formimit Klinik në përputhje me kërkesat e QKEV-it. [RVV fq.30; 41.2; 41.2.1; 41.2.2; <http://www.ual.edu.al/language/en/scientific-research/scientific-activities/>] [Kapitulli I Standardi I.2]
- 3.3 Universiteti i ofron programet në përputhje me Strategjinë e tij të Zhvillimit. Në rast propozimi të një programi të ri, personeli përgatit planin e biznesit, të mbështetur në traditat institucionale, Planin Strategjik, tregun e punës, feedback-un e alumni, infrastrukturën dhe burimet institucionale, si dhe në kuadrot ligjorë. Propozimet paraqiten nga departamentet, por në fund, aplikimet shqyrtohen dhe vendimi përfundimtar merret nga Senati. Gjatë tetë viteve të fundit, është ngritur një fokus grup me punëdhënës dhe alumni, gjë që ka sjellë zhvillime si: përfshirja e specialistëve në ortodonci dhe kirurgji orale dhe ndryshimet kurrikulare në stomatologjinë për fëmijë. [RVV fq.30; 2.0; M3; M6] Universiteti sigurohet që programet e tij të stomatologjisë të jenë në përputhje me kërkesat e hartimit të programeve të Universitetit të Mjekësisë së Tiranës dhe Shoqatës Dentare Shqiptare, të cilat përfshijnë standardet e mbështetura në epidemiologji dhe përhapjen e disa sëmundjeve të caktuara në shkallë vendore. [M6] Objektivat dhe kërkesat për regjistrimin e studentëve përcaktohen në rregulloret e programeve të



universitetit.[RVV fq.30; 25.0; 10.1] Universiteti i informon të diplomuarit rreth çdo ndryshimi ligjor si p.sh lidhur me urdhrat profesionale, si dhe iu ofron informacion rreth tregjeve të ndryshme të punës.[RVV fq.30; 26.2; 26.3; 26.4] Ai i lëshon diplomat së bashku me dokumentet përkatëse, duke përfshirë edhe listën e notave dhe suplementin e diplomës.[RVV fq.30; 10.4][Kapitulli I Standardi I.3]

- 3.4 Universiteti ofron programe studimi në fushat mjekësore në kontekstin e zhvillimeve kombëtare të shërbimeve mjekësore dhe në pajtim me strategjitë kombëtare dhe ndërkombëtare përkatëse, si p.sh me Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë Shqiptare 2016-2020.[RVV fq.31; 2.1; 2.2] Universiteti është përfshirë edhe në një studim të financuar nga BE-ja, lidhur me ofrimin e arsimit të lartë dhe me nevojat e tregut të punës në Ballkanin Perëndimor.[RVV fq.29; EA3-2] Gjithashtu, ai ka lidhur kontrata dhe marrëveshje bashkëpunimi me firma ndërkombëtare për lehtësimin e punësimit të studentëve. (shihni pikën 1.9).[41.1.2][Kapitulli I Standardi I.4]
- 3.5 Infrastruktura dhe kapaciteti akademik i universitetit shërben si mbështetje për programet e tij. Departamentet e planifikojnë ngarkesën vjetore mësimore të stafit akademik, e cila miratohet nga Dekani në bashkëpunim me Rektoren, në përputhje me kërkesat ligjore të MAS-it dhe aktet e brendshme të universitetit.[RVV fq.31; 20.0] Për çdo program studimi me kohë të plotë, mësimdhënia mbulohet në masën 70% nga stafi.[RVV fq.31; 20.1; 20.2; M3] Në rast se ndërmarrin detyra shtesë akademike dhe administrative, anëtarët e personelit marrin pagesa shtesë nga universiteti.[RVV fq.31; 34.5] Gjatë rekrutimit të stafit akademik, universiteti zbaton një proces të kujdesshëm përzgjedhjeje për sigurimin e pasjes së një personeli me aftësi efikase akademike, profesionale dhe administrative, të cilit i jepet mundësia për të marrë pjesë në projekte kërkimore.[RVV fq.31; 38.0][Kapitulli I Standardi I.5]
- 3.6 Përmbajtja e programeve, duke përfshirë edhe objektivat e programeve janë të disponueshme për studentët në katalogun e studentëve dhe në sekretari, si dhe mund të aksesohen përmes faqes së internetit dhe portalit elektronik të studentëve.[RVV fq.31; 30.0; 40.0; <http://www.ual.edu.al/language/en/study-program/1917-2/>; vizita në terren] Në fillim të çdo viti akademik, pedagogët ofrojnë syllabusin e kursit në format të shtypur.[RVV fq.31; 11.7; 34.0] Në mbështetje të udhëzimeve të MAS-it, universiteti publikon kriteret e pranimit dhe informacionin për transferimin e studimeve.[<http://www.ual.edu.al/language/en/students/catalogue/>] Studentët u shprehën se programet i përmbushnin qëllimet dhe objektivat e tyre [Anketimi i Studentëve] dhe ishin të kënaqur me informacionin e ofruar nga pedagogët dhe burimet e tjera si p.sh mjedisi virtual i mësimnxënies (MVM), sekretaritë e departamenteve dhe mediat sociale.[Anketimi i Studentëve; M4; M5][Kapitulli I Standardi I.6]
- 3.7 Universiteti i harton programet e ciklit të parë në mënyrë të tillë që t'i ofrojë studentëve njohuritë, parimet shkencore, si dhe aftësitë dhe shprehitë profesionale themelore, duke lejuar procesin e kalimit nga cikli i parë te i dyti. Studentët u shprehën tejet të kënaqur me shprehitë profesionale që po zhvillojnë. [RVV fq.32; 11.4; Anketimi i Studentëve] Programet organizohen në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve, që lehtëson transferimin e studentëve, të mbështetur nga procedurat e transferimit të studentëve.[RVV fq.32; 27.1; 27.4; M2] Programet e studimit ofrojnë formim profesional, duke i ndihmuar të diplomuarit të gjejnë punë. Shumica e të diplomuarve vazhdojnë të marrin licensa profesionale.[RVV fq.32; 26.2][Kapitulli I Standardi I.7]
- 3.8 Universiteti i mbështet studentët e ciklit të parë përmes një sistemi zyrtar tutorimi, duke filluar që me orientimin e tyre, e duke vijuar përgjatë studimeve. pasi përgatiten, raportet për ecurinë e secilit student publikohen në platformën online.[RVV fq.33;

**16.0; 16.1; 26.0]** Ai përdor metoda alternativa të mësimdhënies, të mbështetura nga një sërë laboratorësh. Studentët vlerësojnë veçanërisht mjediset elektronike të mësimdhënies dhe MVM-në, si dhe shprehen tejet të kënaqur me metodat e mësimdhënies.**[RVV fq.33; 30.0; 35.0; Anketimi i Studentëve]** Stafi me kohë të plotë mbulon 70 për qind të mësimdhënies të çdo programi me kohë të plotë.**[RVV fq. 31; 20.1; 20.2; M3][Kapitulli I Standardi I.8]**

3.9 Të gjithë anëtarët e stafit akademik që japin mësim në programet e ciklit të dytë angazhohen në veprimtari kërkimore, dhe i raportojnë çdo vit departamentit rreth ecurisë së tyre. **[RVV fq.33; 19.0; 19.1; 42.0; EA4-3]** Veprimtaria kërkimore në programet e ciklit të parë dhe të dytë ofrohen nga UAL-ja, siç vërtetohet nga botimet e personelit dhe siç detajohet në raportin vjetor të Këshillit Shkencor 2015-2016.**[42.0; EA4-3]** Praktika profesionale dhe tezat e diplomave zhvillohen në klinikat dhe laboratorët e universitetit, si dhe në institucione të tjera publike dhe jopublike, si për shembull në Spitalin Universitar të Traumës dhe Spitalin Amerikan në Tiranë.**[RVV fq.33; 41.1; 41.1.2; M3; M5; M6]** Rreth 70 për qind e ngarkesës mësimore mbulohet nga stafi akademik me kohë të plotë, që është i kualifikuar nga pikëpamja profesionale.**[RVV fq.35; 20,0;1; 26] [Kapitulli I Standardi I.9]**

3.10 Universiteti harton programe studimi për të lehtësuar mobilitetin e studentëve në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, i cili organizohet në përputhje me Procesin e Bolonjës. Programet e studimit kanë module me kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. **[RVV fq.34; 2.0; 5.0; M2; M3]** Modulet e gjuhës mjekësore në Anglisht dhe Latinisht janë të detyrueshme dhe disa programe ofrojnë mundësi për studimin e një gjuhe të dytë, për shembull programet e fizioterapisë ofrojnë edhe gjuhën italiane.**[RVV fq.34; 40.0]** Studentët e Masterit të Shkencave treguan se mund të komunikonin në gjuhë të huaj në bazë të testeve të njohura në shkallë ndërkombëtare dhe aktualisht, disa prej të diplomuarve janë punësuar jashtë vendit.**[RVV fq.34; 1.2; M2]** Studentët shprehen tejet të kënaqur me aftësitë e tyre të gjuhës së huaj, që është në proces zhvillimi.**[Anketimi i Studentëve]** Aktualisht, tetë prej anëtarëve të personelit janë kualifikuar jashtë vendit, gjë që ka ofruar mundësi për bashkëpunime në shkallë ndërkombëtare, si p.sh marrëveshja e memorandumit me Universitetin e Ferrarës. Megjithatë, vetëm tre prej anëtarëve, që morën pjesë në anketimin e stafit, kanë punuar jashtë vendit pesë vitet e fundit. Universitetit është tejet aktiv në tërheqjen e vizitorëve akademikë në shkallë ndërkombëtare për pjesëmarrjen në seminare, konferenca, formime akademike apo leksione të mbajtura nga lektorë të ftuar.**[42.2; 42.3; Anketimi i Stafit; M2]** Universiteti i shqyrton falas kërkesat për transferimet e studentëve. **[27.4]** Studentët mund të udhëtojnë jashtë vendit për trajnime të shkurtra, si për shembull për kurse dyditore në ortodonci dhe kirurgji orale, në Itali; si dhe një kurs dyditor në protetikë fikse, në Gjermani. **[FE8.1; M1]** Megjithatë, studentët u shprehën se mundësitë për mobilitet ishin të kufizuara, duke përmendur probleme lidhur me burokracitë dhe natyrën mjekësore të programit. Rezultatet e anketimit të studentëve, treguan se vetëm tetë për qind e studentëve kanë studiuar jashtë vendit si pjesë e kursit të tyre.**[Anketimi i Studentëve; M5]** Personeli e vlerëson ndërkombëtarizimin e universitetit si të mjaftueshëm.**[Anketimi i Stafit] [Kapitulli I Standardi I.10]**

3.11 Programet mbështeten në punë klinike dhe përbëhen nga një numër i konsiderueshëm kreditesh, që i japin mundësinë studentëve të përvetësojnë aftësitë praktike. Universiteti ka 28 laboratorë dhe klinika me pajisje bashkëkohore, të cilat mbështesin zhvillimin e aftësive dhe kompetencave profesionale, ambiente për të cilat studentët janë shprehur tejet të kënaqur. **[RVV fq.34; 33.0; 34.6; Anketimi i Studentëve; vizita në terren]** Studentët ndërmarrin projekte kërkimore në programet e ciklit të parë dhe të dytë, të cilat i ndihmojnë të përgatisin tezat e tyre të



diplomës.[RVV fq.35; 10.2; M5] Universiteti organizon veprimtari kulturore dhe edukative në bashkëpunim me Këshillin Studentor, si p.sh konferenca studentore, shkolla verore dhe dimërore apo kampionate sportive.[RVV fq.35; 17.3; EA4-4; <http://www.ual.edu.al/language/en/students/3858-2/>; M2; M5] Kampusi i ri, që po planifikohet të ndërtohet, do të ofrojë më shumë ambiente sportive, siç përmendet edhe në pikën 2.11.[RVV fq.46-47; 33.1] [Kapitulli I Standardi I.11]

- 3.12 Programet ndërthurin aftësitë teorike me ato praktike, [RVV fq.36; 10.2; 23.0; 24.0] si dhe studentët mund të ndjekin rastet klinike.[RVV fq.36; RVV dok 41.1] Programet përfshijnë kurse për menaxhimin e shëndetit, projekte laboratorike dhe stazhe, që zhvillohen nën mbikëqyrjen e mentorëve.[RVV fq.36; 42.4; 15.0] Gjithashtu, universiteti i ofron studentëve mundësi për t'i kryer praktikat profesionale në ambientet e tij apo në organizata të tjera.[41.1; M4] Studentët përmendën si shembuj praktikat profesionale që kryenin në spitale, farmaci dhe jashtë vendit, si në Slloveni.[M4] Ata informohen rreth mundësive për punësim nga fillimi i programit, e deri në fund të studimeve të tyre. Atyre iu ofrohet akses në Zyrën e Këshillimit të Karrierës, si dhe iu ofrohen udhëzime për punësim nga Alumni të Universitetit.[M2; M3] Partnerët e jashtëm nga Urdhri i Infermierit raportojnë se kurrikula e universitetit është përshtatur mirë me mundësitë që ofrohen brenda BE-së, për shkak të nivelit të lartë të punës praktike dhe standardeve të larta të studentëve.[M6] Në përgjigje të raportit të Shoqatës së Informacionit Mjekësor, në të cilin identifikohet kërkesa e lartë për implantologji dhe ortodonci, aktualisht, "Aldenti" është i vetmi universitet në Shqipëri, që përgatit specialistë të kësaj fushe. [M6][Kapitulli I Standardi I.12]

## **Gjetje**

### **Praktika e mirë**

Grupi i vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

### **Dobësitë**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

### **Rekomandime**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

### **Pohimi i veprimeve të ndërmarra**

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë.

## **Gjykimi**

**Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.**

## Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 Programet e studimit bazohen në kuadrin ligjor dhe janë në përputhje me planin mësimor. Përgjegjësitë për organizimin e tyre efikas përcaktohen në rregulloret e universitetit. **[3.0; 33.0]**Oferta akademike e universitetit gjendet si në format të shtypur, ashtu edhe në format elektronik në faqen e tij të internetit.**[RVV fq.37; 11.4; 11.5; 11.6; 40.0; <http://www.ual.edu.al/language/en/study-program/1917-2/>]** Departamentet i rishikojnë programet e tyre në fillim të vitit akademik, duke propozuar ndryshime dhe përmirësime, të cilat miratohen nga fakulteti dhe Senati Akademik. Më pas, syllabuset e çdo lënde miratohen dhe nënshkruhen nga Përgjegjësi i Departamentit. **[RVV fq.37; 4.1; 11.3; 11.7; M2]** Universiteti e afishon orarin mësimor në një vend publik dhe në faqen e tij të internetit.**[11.8; <http://www.ual.edu.al/language/en/students/academic-calendar/>]** Në programe përfshihen praktika profesionale, të cilat zhvillohen në universitet ose në organizata të tjera publike dhe jopublike, si në Spitalin Universitar të Traumës dhe farmacitë private, në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara.**[41.1; 41.1.2; vizita në terren; M3; M5; M6]** Praktika profesionale mbikëqyret nga personeli përgjegjës, në përputhje me rregulloret dhe procedurat përkatëse. **[15.0; 15.1; 15.2]** Biblioteka e universitetit ofron tekste shkollore dhe literaturë bashkëkohore në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj.**[12.1; turi në terren]** Studentët janë të kënaqur me bibliotekën, të cilët nxiten nga universiteti ta përdorin sa më shumë.**[Anketimi i Studentëve; M4][Kapitulli I Standardi II.1]**
- 4.2 Rregullat dhe kërkesat e provimeve përfshihen në rregulloret institucionale, të cilat miratohen nga Dekani dhe Senati. Studentët informohen vazhdimisht rreth vlerësimit nëpërmjet platformës digjitale, ose në mënyrë të drejtpërdrejtë nga pedagogu. Nëntëdhjetë për qind e studentëve shprehen të kënaqur me vlerësimin e provimeve, ndërsa nëntëdhjetë për qind e tyre shprehen të kënaqur me mbështetjen që iu ofrohet për vlerësimin. Megjithatë, 54 për qind e studentëve raportojnë se nëpër provime kopjohet, ndërsa 32 për qind shprehen se notat e provimeve mund të publikohen pa dijeninë tyre dhe se universiteti duhet të marrë masa për trajtimin e këtyre shqetësimeve.**[3.0; 11.7; Anketimi i Studentëve; M3]** Rregulloret akademike garantojnë përmes praktikave të vlerësimit ruajtjen e anonimitetit të studentëve. **[3.0; M3]** Universiteti i publikon rezultatet e vlerësimeve në platformën elektronike, e cila aksesoret nga studentët.**[RVV fq.38; 31.0; M4; turi në terren]** Procesi i ankesave rreth rezultateve të provimit përcaktohet në rregulloret e programeve.**[3.0; M3]** Studentët cituan disa pjesë të procedurave të vlerësimit, dhe dinin se si t'i paraqisnin ankesat e tyre, nëse kishin, por nga Anketimi i Studentëve doli se, 15 për qind e tyre nuk kishin informacion rreth procedurës së ankesave dhe 22 për qind nuk ishin në dijeni të procesit të ankimimit.**[Anketimi i Studentëve; M4]** Menjëherë pas përbushjes së detyrimeve akademike, studentët e mbrojnë diplomën e tyre në përputhje me kriteret dhe procedurat akademike.**[RVV fq.39; 14.0]** Universiteti i lëshon diplomat së bashku me dokumentet përkatëse, ku përfshihen lista e notave dhe suplementi i diplomës, në përputhje me kërkesat e MAS-it.**[RVV fq.30; 10.4][Kapitulli I Standardi II.2]**
- 4.3 Universiteti i rishikon programet e studimit, kur është e nevojshme, në përputhje me ndryshimet e kuadrit ligjor dhe kërkesave të tregut të punës.**[11.3; 26.3; EA3-1; M1; M6]** Njësia Akademike e Mësimdhënies vlerëson rregullisht stafin akademik, mbledh dhe verifikon syllabuset kundrejt kurrikulës, si dhe mbikëqyr ngarkesën mësimore të çdo pedagogu. Të gjithë studentët, që morën pjesë në Anketimin e Studentëve u shprehën të kënaqur me oraret mësimore. **[RVV fq.39; 1.4; 20.0; 20.1; Anketimi i Studentëve]** Studentët i plotësojnë anketimet për të vlerësuar pedagogët dhe

programet e tyre të studimit, ndërsa mendimet e tyre mblidhen nga NJSBC-ja. **[RVV fq.39; 7.3; 7.5; M3]** Studentët plotësojnë dy pyetësorë në vit lidhur me infrastrukturën, mësimdhënien dhe gatishmërinë e stafit për të ndihmuar, informimin dhe fusha të tjera, si dhe raportuan se i shprehin lirisht mendimet e tyre rreth pedagogëve dhe metodave të mësimdhënies apo çështjeve të tjera si disponueshmëria e veprimtarive sportive. Ata janë tejet të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies dhe materialeve të përdorura nga stafi. **[7.4; Anketimi i Studentëve; M4]** Performanca e stafit akademik vlerësohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore, në bazë të performancës së tyre në mësimdhënie dhe mësimnxënie. **[RVV fq.39; 18.2; M7]** Në bazë të këtij vlerësimi, universiteti vendos nëse performanca e anëtarit të stafit është në nivelin e duhur, ose nëse duhet të marrë masa. Si rrjedhojë e këtij procesi, ka pasur raste kur disa pedagogë janë ngritur në detyrë, ashtu siç ka pasur edhe raste kur disa të tjerëve nuk iu është rinovuar kontrata. **[M7][Kapitulli I Standardi II.3]**

4.4 Përgjegjëse për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies është NJSBC-ja, e cila harton raportin e hollësishëm vjetor, duke u mbështetur në rezultatet e pyetësorëve të studentëve, lidhur me vlerësimin e mësimdhënies, veprimtarisë dhe rezultateve kërkimore, dhe gjendjen financiare të universitetit. **[RVV fq.40; 7.0; 7.2]** Feedback-u i studentëve merret në konsideratë nga universiteti, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u informua se si kjo gjë kishte ndryshuar ekuilibrin ndërmjet vlerësimeve laboratorike dhe vlerësimeve të tjera, në përputhje me shqetësimet e studentëve. **[M3]** Universiteti ka një sërë laboratorësh dhe klinikash, të cilat ofrojnë kujdes për pacientët, si dhe mbështesin mësimdhënien dhe zhvillimin e aftësive dhe kompetencave klinike. **[RVV fq.40; 33.1; 34.6; vizita në terren]** Universiteti bashkëpunon me studentët, si për shembull në ofrimin e workshop-eve të përbashkëta për komunikimin efikas ndërmjet personelit dhe studentëve. **[RVV fq.40; 11.10]** Universiteti i përdor siç duhet teknologjitë ndërvepruese për mbështetjen e procesit të mësimdhënies, si për shembull MVM-në dhe bibliotekën e pasur online. Sipas rezultateve të Anketimit të Studentëve, 98 për qind dhe 97 për qind e studentëve e shikojnë zbatimin e metodave të të nxënit elektronik dhe burimeve online si të mjaftueshme. **[RVV fq.40; 35.0; 45.0; Anketimi i Studentëve]** Çdo vit, universiteti organizon një sërë workshop-esh për pedagogët, të cilat zakonisht mbahen nga lektorët ndërkombëtarë. Në këtë trajnim, edhe Zyra e Këshillimit të Karrierës jep kontributin e saj. Universiteti organizon edhe trajnime akademike nga profesionistët e institucioneve të tjera shqiptare. **[RVV fq.40; 44.2; 42.3; M7; M8]** Stafi mësimdhënës raportoi se trajnimi në kërkim, mësimnxënie dhe vlerësim, që ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, i kishte ndihmuar të komunikonin me studentët dhe se e konsideronin përfshirjen e lektorëve ndërkombëtarë si të dobishme. **[M8]** Departamentet organizojnë veprimtari të edukimit në vazhdim, të cilat janë akredituar nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim **[RVV fq.40; 42.4; M8]**. Universiteti mbështet pjesëmarrjen e personelit në projekte kërkimore si brenda, ashtu edhe jashtë vendit, ndërsa 37 për qind e personelit raportojnë se kanë ndërmarrë projekte individuale. **[RVV fq.40; 15.0; Anketimi i Stafit; M8][Kapitulli I Standardi II.4]**

